

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Berisha nga Strasburgu: Dënimet për 4 ish-krerët e UÇK kanë ndjekur linja të qarta etnike, Gjykata ka ndjekur penalisht vetëm palën e viktimës dhe jo agresorin! - Shqiptarja.com
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/berisha-nga-strasburgu-denimet-per-4-ishkreret-e-uck-kane-ndjekur-linja-te-qarta-etnike-gjykata-ka-ndjekur-penalisht-vetem-palen-e-viktimes-dhe-jo-a-gresorin
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 13:35:34 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 13:35:02 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	efa8a732ae082cede835c0a59bdf5a408d8585bf17e3b74fba21af7c06bfd0ee
TEKSTI	bfddeb054c5413e4c7af8e808303819599b51aef19d9e87d4163462b9318dec51
PAMJA	e15c019536010ae2702b2acf5621098f6613d4031e9936695939abf29d5be475

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	453061cb9ca5feca72aca39a663ad616a8aad5586d0216e6ec0313658a4c7cc5
E MËPARSHMJA	e526d74c26069f7cf33af8cf1afeeb4c4c52aec6c8cbf3159723fe0698a18e74
RRËNJA MERKLE	5df8b09a82e67beafe6b324836ab8231b0f747e1cb5c8d4c8cb1ac702cd5a645
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/453061cb9ca5feca72aca39a663ad616a8aad5586d0216e6ec0313658a4c7cc5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



"Shteti i së drejtës, në qendër të rrugës drejt BE-së", ambasadorja e BE-së zbardh takimin me Ervin Dëmon: Të vijojë lufta kundër krimit të organizuar

Politikë

Berisha nga Strasburgu: Dënimet për 4 ish-krerët e UÇK kanë ndjekur linja të qarta etnike, Gjykata ka ndjekur penalisht vetëm palën e viktimës dhe jo agresorin!

Duke folur për dënimin me 81 vite burg të 4 ish-krerëve të UÇK-së në Hagë, Berisha kritikoi proceset gjyqësore dhe pretendoi se ndjekja penale ka ndjekur "linja të qarta etnike", ndërsa kërkoi që Gjykata e Apelit t'i shqyrtojë çështjet në mënyrë më objektive.



Sali Berisha, foto nga arkivi



Redaksia

29 Shtator, 15:32 | Përditësimi: 29 Shtator, 15:35

Share Tweet

A A

Kryetari i Partisë Demokratike, [Sali Berisha](#), ka mbajtur një fjalim ditën e djeshme në [Strasburg](#), në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës, ku ka ngritur një sërë çështjesh që lidhen me Kosovën, proceset gjyqësore ndaj 4 ish-krerëve të [UÇK](#) në Hagë dhe zhvillimet në Serbi.

Lidhur me zgjedhjet e përsëritura parlamentare që janë zhvilluar gjatë një harku të shkurtër kohor në [Kosovë](#), Berisha tha se ato janë zhvilluar në përputhje të plotë me parimet dhe standardet ndërkombëtare.



"Zgjedhjet e përsëritura në Kosovë, për sa i përket respektimit të parimeve ndërkombëtare për zgjedhjet parlamentare, pavarësisht motivit të tyre, janë zhvilluar në përputhje me këto parime", tha Berisha.



[Sh]
.com

LEXO EDHE:

Tabaku pas takimit me Hofreiter: Gjermania ka shqetësime për sundimin e ligjit dhe zonat e mbrojtura

Berisha u shpreh se përsëritja e zgjedhjeve për shkak të mos-dakordësisë për zgjedhjen e Presidentit duhet të shmanget, duke kërkuar asistencën e Këshillit të Europës dhe Komisionit të Venecias për gjetjen e një zgjidhjeje.

"Askush nuk e përjetoi kundër ndërkombëtit të krimave, por disa krime dhe mungesa e



"Gjykata nuk ngrehet ndaj ndërmirimit të krimet, por ajo mund të jetë mungesa e provave të qarta për krime konkrete kanë shkaktuar zemërim publik", theksoi Berisha.

Duke folur për dënimin me 81 vite burg të 4 ish-krerëve të UÇK-së në Hagë, Berisha kritikoi proceset gjyqësore dhe pretendoi se ndjekja penale ka ndjekur "linja të qarta etnike", ndërsa kërkoi që Gjykata e Apelit t'i shqyrtojë çështjet në mënyrë më objektive. Për Berishën, Gjykata ka ndjekur penalisht vetëm palën e viktimës dhe jo agresorin, që është Serbia.

"Dënimet e dhëna nga gjykata e Kosovës në Hagë kanë ndjekur, në mënyrë befasuese, linja të qarta etnike. Në kundërshtim me statutin e saj, gjykata ka ndjekur penalisht vetëm palën e viktimës dhe jo agresorin. Prandaj, le të shprejmë që Gjykata e Apelit t'i shqyrtojë çështjet e tyre në mënyrë më objektive", shtoi Berisha.

Nër përfundim Berisha foli edhe për varrimin me nderime të larta shtetërore në Serbi të Ratko Mlladiç, i njohur si 'kasapi i Bosnjës' për gjenocidin në Srebrenicë.

"Varrimi me nderime shtetërore i kasapit të Bosnjës, orkestruesit të gjenocidit më të madh në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore në Srebrenicë, ishte një ekzekutim i dytë, 31 vjet më vonë, i 8500 djemve dhe burrave, vetëm për shkak të përkatësisë së tyre fetare dhe etnike", përfundoi Berisha.

R.Xh/Shqiptarja.com

TAG: [sali berisha](#) [PD](#) [Strasbourg](#) [Gjyqi ndaj UCK ne Hage](#) [uck](#) [kosove](#)

Sa e vlerësoni këtë artikull? ★ ★ ★ ★ ★

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento

Ndalohet repteisist ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH
FORUM

Sondazhi i ditës:

26 Shtator, 18:15

Ambasadori i ri i SHBA nis misionin, a besoni se do sjellë ndryshim në mjedisin politik?

Po Jo Disi

Lajme të tjera



Zyrtarë të Listës Serbe dyshohen për sulm ndaj rendit kushtetues të Kosovës dhe vepra të tjera penale

29 Shtator, 15:12



PD 146 pyetje Begajt dhe Ramës pas arrestit të Hysenit: Çfarë kriteresh dhe verifikimesh u ndoqën për emërimin e saj në krye të SHISH? (PYETJET)

29 Shtator, 14:27



Ursula von der Leyen nis nesër turin ballkanik, ndalesa e parë Tirana! Presidentja e KE sjell planin e anëtarësimit për 4 shtete

29 Shtator, 09:57



Spaho përplaset me Arjana Kalanë: Harrove sa ma ke sharë Berishën kur s'të bëri Avokate Populli? Do t'i nxjerr mesazhet?

29 Shtator, 09:20



Kushtetuesja rrëzon kërkesën e PD, Endri Shabani mbetet Avokat i Popullit

29 Shtator, 09:03



Javë vendimtare në Kosovë: President ose zgjedhje të reja

29 Shtator, 08:56





Analiza: A do të ndryshohet ligji për Gjykatën Speciale në Kosovë?

28 Shtator, 22:54



Kosovë/ Vendimi ndaj ish-krerëve të UÇK, sot nata e 13-të e protestës 'Jo në emrin tim'

28 Shtator, 21:25



Analiza: Çfarë i karakterizoi 14 vitet e Vuçiç në pushtet?

28 Shtator, 20:14



Arrestet e ish-krut të SHISH/ PD kërkon dorëheqjen e Ramës, Spaho: Opozita di të bëjë vetëm zhurmë në Kuvend! Mazhoranca nuk është lëkundur

28 Shtator, 18:23



Kosovë/ Partitë pa marrëveshje për Presidentin e ri, afati drejt përfundimit

28 Shtator, 17:10



Gazment Bardhi takon ambasadoren e re të Holandës në Shqipëri: Reforma zgjedhore e territoriale po zhvillohen pa konsensus

28 Shtator, 16:10

[Kodi Etik](#)

[Kontakt](#)

[Rreth Nesh](#)

[Raportoni Ju](#)

[Puno me ne](#)

[Shqiptarja.com]

Kërko



© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohej riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.